



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.238/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nika” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-87312-02-16-2021, me objekt “*Rikonstruksion i tregut fshatar*”, me Fond limit 49.998.000 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:** “Nika” SHPK  
Lagjja “Vasil Shanto”, Blv Skënderbeu, pas Kinema “Millenium” Shkodër

**Autoriteti kontraktor:** Bashkia Durrës  
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.02.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-87312-02-16-2021, me objekt “Rikonstruksion i

tregut fshatar”, me Fond limit 49.998.000 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 19.03.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.03.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- LTE Construction	31,983,750	I skualifikuar
- Nika	34,824,635	I skualifikuar
- Colombo	35,574,239	I kualifikuar
- Eurovia	38,495,134	I skualifikuar
- Rafin Company	39,425,600	I skualifikuar
- Al-Asfalt	44,959,350	I skualifikuar
- MF Invest Group	44,959,850	I skualifikuar
- Leon Konstruksion	46,494,000	I skualifikuar
- Biba X	49,911,910	I skualifikuar

II.4. Në datën 29.03.2021 operatori ekonomik “Nika” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Për ofertuesin NIKA SHPK me vlerë të ofertës 34’824’635 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:  
Per piken 2.3.1 Kapacitetin teknik germa “h”, është kërkuar në dokumentat standarde të procedurës: → Punëtori e specializuar në ndërtim: o elektrikist 2 punonjës o karpentier 4 punonjës o hekurkthyes 4 punonjës o saldator 5 punonjës o hidraulik 2 punonjës o murator 3 punonjës o pllakashtrues 6 punonjës o bojaxhi 10 punonjës  
Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.  
Ofertuesi NIKA SHPK për puntorinë e specializuar të sipërcituar nuk ka paraqitur “dëshmi profesionale të punonjësve teknik” për secilin punonjës.  
KVO vendos që ofertuesi NIKA SHPK të mos kualifikohet.*

II.5. Në datën 01.04.2021 operatori ekonomik “Nika” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

*Në lidhje me këtë shkak skualifikimi në pikën 2.3.1 kapaciteti teknik gërma h të DT është parashikuar:*

*Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:*

➤ <i>Inxhinier Ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Inxhinjer Topograf</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Inxhinjer Hidroteknik</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Teknik ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>
➤ <i>Punëtori e specializuar me makineri, Manovratorë</i>	<i>5 punonjes</i>
➤ <i>Drejtues mjete</i>	<i>8 punonjes</i>
➤ <i>Punëtori e specializuar në ndërtim:</i>	
○ <i>elektracist</i>	<i>2 punonjës</i>
○ <i>karpentier</i>	<i>4 punonjës</i>
○ <i>hekurkthyes</i>	<i>4 punonjës</i>
○ <i>saldator</i>	<i>5 punonjës</i>
○ <i>hidraulik</i>	<i>2 punonjës</i>
○ <i>murator</i>	<i>3 punonjës</i>
○ <i>pllakashtrues</i>	<i>6 punonjës</i>
○ <i>bojaxhi</i>	<i>10 punonjës</i>
➤ <i>Punetore ndertimi te thjeshte</i>	<i>32 punonjes</i>

*Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të paraqitet një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

*Për të gjithë punonjësit e sipërpërmendur të paraqitet listëpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumente të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).*

*Sic rezulton nga më sipër për stafin teknik të shoqërisë janë kërkuar diplomat/licenca e inxhinierëve të ndërtimit, topograf dhe hidroteknik, dëshmi profesionale të punonjësve teknik për Teknikun e Ndërtimit dhe për 32 punëtorë të thjeshtë ndërtimi është një vetëdeklarim me emra konkretë nga shoqëria.*

*Nga sa më sipër rezulton se për punëtorët e specializuar në ndërtim nuk është parashikuar se çfarë dokumentesh duhet të paraqiten përveç listëpagesave sipas formularëve standard për sigurimet, për muajin e fundit të cilit i takojnë pagesat me me datën e hapjes së ofertës. Dokumente të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).*

*Pavarësisht se në DT nuk është parashikuar dokumentacioni që duhet për punëtorët e specializuar në ndërtim shoqëria Nika SHPK për të provuar specialitetin e punëtorëve të mësipërm në ndërtim, 2 elektrikist, 4 karpentier, 4 hekurkthyes, 5 saldatorë, 2 hidraulik , 3 murator, 6 pllakashtrues, 10 bojaxhi ka paraqitur IQT (Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik) të lëshuara nga ISHTI dhe HVAT organizëm certifikimi i akredituar nga DPA si dhe certifikata trajnimi të lëshuara nga AQS Cert SHPK e Re/Plus SHPK, organizma certifikues të akredituar nga DPA.*

*Duke u bazuar në sa më sipër dhe nga vetë kriteret e DT në lidhje me këtë pikë (punëtori e specializuar në ndërtim) nga ana e OE Nika SHPK janë ngarkuar në SPE punonjësit e specializuar në ndërtim së bashku me dokumentacionin e nevojshëm si më poshtë vijon:*

*Elektricitist 2 punonjës me dokumentacionin si më poshtë:*

- 1. Nikolin Kola me kontratë pune , IQT dhe Certifikatë Trajnimi*
- 2. Fran Kasneci me kontratë pune dhe IQT*

*Karpentier 5 punonjës (1 më tepër se në DT) me këto dokumente:*

- 1. Fabian Fushazi me kontratë pune dhe IQT*
- 2. Gjovan Fushazi me kontratë pune dhe IQT*
- 3. Ismet Lila me kontratë pune dhe IQT*
- 4. Myfit Ferati me certifikatë trajnimi*
- 5. Nexhat Hysa me certifikatë trajnimi*

*Hekurkthyes 4 punonjës me këto dokumente:*

- 1. Gjergj Lekndrejaj me kontratë pune dhe IQT*
- 2. Alfons Gjellaj me kontratë pune dhe IQT*
- 3. Martin Marku me kontratë pune dhe IQT*
- 4. Gëzim Qetaj me kontratë pune dhe IQT*

*Saldatorë 5 punonjës me këto dokumente*

- 1. Gjeto Prroj me kontratë pune dhe IQT*
- 2. Gjon Prendi me kontratë pune dhe IQT*
- 3. Gjoke Skollaj me kontratë pune dhe IQT*
- 4. Sandër Nika me kontratë pune dhe IQT*
- 5. Sokol Qetaj me kontratë pune dhe IQT*

*Hidraulikë 2 punonjës me këto dokumente*

- 1. Luigj Shehu me kontratë pune, IQT dhe certifikatë trajnimi*
- 2. Mondi baca me kontratë pune , IQT dhe certifikatë trajnimi*

*Murator 4 punonjës me këto dokumente*

- 1. Agron Gula me kontratë pune dhe IQT*
- 2. Agron Qukaj me kontratë pune dhe IQT*
- 3. Niko Velo me kontratë pune dhe IQT*
- 4. Ervis Lita me kontratë pune dhe IQT*

*Pllakashtrues 6 punonjës me këto dokumente*

- 1. Abdyl Tyrbetari me kontratë pune dhe IQT*
- 2. Gjon Preka me kontratë pune dhe IQT*
- 3. Bledi Goleshi me kontratë pune dhe IQT*
- 4. Angjelin Gështenja me kontratë pune dhe certifikatë trajnimi*
- 5. Xhesjan Shehu me kontratë pune dhe certifikatë trajnimi*
- 6. Tahir Pervataj me kontratë pune dhe certifikatë trajnimi*

*Bojaxhinj 12 punonjës me këto dokumente*

- 1. Festim Bajrami me kontratë pune dhe IQT*
- 2. Arben Mustafa me kontratë pune dhe IQT*
- 3. Arben Hasa me kontratë pune dhe IQT*
- 4. Hektor Marku me kontratë pune dhe IQT*
- 5. Agron Shehu me kontratë pune dhe IQT*
- 6. Desart Ismaili me kontratë pune dhe IQT*
- 7. Emanuel Nika me kontratë pune dhe IQT*
- 8. Erjon Stermulli me kontratë pune dhe IQT*
- 9. Gëzim Boshti me kontratë pune dhe IQT*
- 10. Ladimir Marku me kontratë pune dhe IQT*
- 11. Marsel Trasha me kontratë pune dhe certifikatë trajnimi*
- 12. Eltor Goxhaj me kontratë pune dhe certifikatë trajnimi.*

*Për të gjithë punonjësit e mësipërm janë paraqitur edhe listëpagesa sipas formularëve standard për sigurimet për muajin e fundit të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertave.*

*Vendimi i KVO është haptazi i padrejtë, dhe në kundërshtim me ligjin dhe kriteret e DT pasi siç e keni shprehur edhe më sipër për punëtorët e specializuar në ndërtim nuk janë përcaktuar se çfarë kriteresh duhen. Nga ana jonë nuk kuptohet se çfarë nënkupton KVO me shprehjen dëshmi profesionale të punonjësve teknikë kur për punonjësit e kërkuar janë paraqitur dëshmitë profesionale siç e parashikon ligji. Për më tepër përveçse KVO ka përdorur një shprehje evazive që lë shteg për shumë*

*nënkuptime ajo nuk ka përcaktuar se cilët nga punonjësit e mësipërm nuk janë të pajisur me dëshmi profesionale të punonjësve teknikë. Nëse me dëshmi profesionale të punonjësve teknikë KVO nënkupton një diplomë të shkollës së mesme apo arsim të mesëm profesional për punonjësit e mësipërm atëherë kjo është haptazi në kundërshtim me ligjin pasi këta punëtorë nuk mund të barazohen me teknikët e mesëm. Siç rezulton më sipër dhe nga vetë termi i përdorur në DT punëtori e specializuar në ndërtim këta persona nuk janë as punonjës teknik me shkollë të mesme apo diplomim profesional të mesëm as punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

*Për këtë arsye vlerësojmë se trajtimi nga KVO si punonjës teknikë i punëtorit të specializuar në ndërtim është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj, VKM 514/2017 e kriteret e DT për shkak se nuk është kërkuar në DT që këta punëtorë të specializuar të jenë teknikë pasi duke u bazuar në legjislacionin e sotëm të punës dhe profesioneve këto profesione elektrikistë, karpentier, saldatorë, hekurkthyes, muratorë, pllakashtrues, hidraulikë, bojaxhi nuk mund të jenë punonjës teknikë me shkollë të mesme apo diplomim të mesëm profesional por punëtorë të specializuar të pajisur me dëshmi profesionale apo certifikata trajnimit të marra në kurse të organizuara ose nga institucione shtetërore , ose nga organizma certifikues të akredituar nga DPA ashtu siç i kemi paraqitur edhe ne.*

*Në bazë të VKM nr.514 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve, të rishikuar punonjësit teknikë në fushën e ndërtimit parashikohen në grup njësi profesioni Teknikë të inxhinierisë civile me kod profesioni 311 ndërsa punonjësit e specializuar në ndërtim parashikohen në nëngrupin e madh të fushës së ndërtimit “punonjës të ndërtimit dhe profesione të lidhura me to” me kod profesioni 711, pastaj me nënndarje të veçanta për çdo kategori. Pra siç rezulton nga VKM 514/2017 punonjësit teknikë në fushën e ndërtimit janë me kod profesioni të ndryshëm nga punonjësit e specializuar në ndërtim ku njëra përshihet në kodin e profesionit 311 dhe tjetra 711.*

*Për këtë arsye vlerësojmë se kategorizimi që ka bërë KVO duke i cilësuar punëtorët e specializuar në ndërtim si punonjës teknikë është haptazi në kundërshtim me ligjin dhe vetë kriteret e DT dhe kjo nuk mund të përbëjë shkak për skualifikim lidhur me një kriter të paparashikuar në DT. Për të vetmin punonjës teknik që ka kërkuar AK në DT është tekniku i ndërtimit për të cilin shoqëria Nika SHPK ka paraqitur shtetasin Edmond Manoku i cili figuron në listëpagesat e shoqërisë Nika për periudhën e kërkuar dhe me dokumentacionin e plotë, kontratë pune e rregullt, diplomë profesionale e shkollës së mesme dhe IQT të vlefshme lëshuar nga ISHTI.*

*Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.*

II.6. Në datën 08.04.2021 me shkresën nr.305/9 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 15.04.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.305/16 prot datë 29.04.2021 protokolluar me tonën me nr.608/2 prot datë 04.05.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nika” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: *Për ofertuesin NIKA SHPK me vlerë të ofertës 34’824’635 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se: Per piken 2.3.1 Kapacitetin teknik germa “h”, eshte kerkuar ne dokumentet standarde te procedures:*

*Punëtori e specializuar në ndërtim:*

- *elektracist 2 punonjës;*
- *karpentier 4 punonjës;*
- *hekurkthyes 4 punonjës*
- *saldator 5 punonjës*
- *hidraulik 2 punonjës*
- *murator 3 punonjës*
- *pllakashtrues 6 punonjës*
- *bojaxhi 10 punonjës*

*Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ofertuesi NIKA SHPK per puntorine e specializuar te sipërcituar nuk ka paraqitur “dëshmi profesionale të punonjësve teknik” per secilin punonjes. KVO vendos qe ofertuesi NIKA SHPK të mos kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.1 gërma h “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:



a. Staf i teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

➤ Inxhinier Ndertimi	1 (nje)
➤ Inxhinjer Topograf	1 (nje)
➤ Inxhinjer Hidroteknik	1 (nje)
➤ Teknik ndertimi	1 (nje)
➤ Punëtori e specializuar me makineri, Manovratorë	5 punonjes
➤ Drejtues mjete	8 punonjes
➤ Punëtori e specializuar në ndërtim:	
○ elektrikist	2 punonjës
○ karpentier	4 punonjës
○ hekurkthyes	4 punonjës
○ saldator	5 punonjës
○ hidraulik	2 punonjës
○ murator	3 punonjës
○ pllakashtrues	6 punonjës
○ bojaxhi	10 punonjës
➤ Punetore ndertimi te thjeshte	32 punonjes

*Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të paraqitet një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

*Për të gjithë punonjësit e sipërpermendur të paraqitet listëpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumente të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Nika” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Marsel Trasha në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë Pjesmarrje Në kursin me temë: “Bojaxhi” kod. B0013 i kryer në Tiranë në datë 29 Qershor 2020 Përmbajtja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë., lëshuar nga Re/Max Plus SHPK
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Eltorr Goxhaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë Pjesmarrje Në kursin me temë:

- “Bojaxhi” kodi. B0013 i kryer në Tiranë në datë 29 Qershor 2020 Përmbajtja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë., lëshuar nga Re/Max Plus SHPK.
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Festim Bajrami në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi)
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Arben Mustafa në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Arben Hasa në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Hektor Marku në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Agron Shehi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Desart Ismaili në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Emanuel Nika në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Erjon Stërmolli në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gëzim Boshti në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Ladimir Marku në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin

Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik (bojaxhi).

- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e pundëshënësit dhe Nikolin Kola në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, (profesioni elektrikist), Certifikatë Trajnimi Kurs Trajnimi për Elektricitist lëshuar nga AQSCERT.
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e pundëshënësit dhe Fran Kasneci në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, (profesioni elektrikist).
  
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e pundëshënësit dhe Luigj Shehu në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni hidraulik), Certifikatë Trajnimi Kurs Trajnimi për Hidraulik lëshuar nga AQSCERT.
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e pundëshënësit dhe Mondi Baça në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni hidraulik), Certifikatë për mbarimin e kursit hidraulik lëshuar nga Subjekti privat i formimit profesional S.O.L Korçë.
- Certifikatë mbi sigurimin teknik Vasil Hyseni (profesioni hidraulik)
  
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e pundëshënësit dhe Myfid Ferhati në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, CERTIFIKATË PJESMARRJE Vërtetohet pjesmarrja dhe kalimi i provimit të Z. MYFID FERHATI Në kursin me temë: “Karpientier” kodi. K0023 i kryer në Tiranë në datë 18 Qershor 2020 Përmbytja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, lëshuar nga Re/Max Plus
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e pundëshënësit dhe Nexhat Hysa në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, CERTIFIKATË PJESMARRJE Vërtetohet

- pjesmarrja dhe kalimi i provimit të Z. NEXHAT HYSA Në kursin me temë: “Karpientier” kodi. K0023 i kryer në Tiranë në datë 18 Qershor 2020 Përmbajtja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, lëshuar nga Re/Max Plus.
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Fabian Fushazi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni karpentier).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjovalin Fushazi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni karpentier).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Sami Koçi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni karpentier).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Ismet Lila në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni karpentier).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Agron Gula në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik (profesioni Murator).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Agron Qukaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik (profesioni Murator).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Niko Velo në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni Murator).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Ervis Lita në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve që disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni Murator).

- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Angjelin Geshteja në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, CERTIFIKATË PJESMARRJE Vërtetohet pjesmarrja dhe kalimi i provimit të Z. ANGJELIN GESHTENJA Në kursin me temë: “Pllakashtrues” kod. PSH0012 i kryer në Tiranë në datë 22 Qershor 2020 Përmbytja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë lëshuar nga Re/Max Plus.
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Xhesjan Shehu në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, CERTIFIKATË PJESMARRJE Vërtetohet pjesmarrja dhe kalimi i provimit të Z. XHESJAN SHEHU Në kursin me temë: “Pllakashtrues” kod. PSH0012 i kryer në Tiranë në datë 22 Qershor 2020 Përmbytja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë lëshuar nga Re/Max Plus
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Tahir Pervataj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, CERTIFIKATË PJESMARRJE Vërtetohet pjesmarrja dhe kalimi i provimit të Z. TAHIR PERVATAJ Në kursin me temë: “Pllakashtrues” kod. PSH0012 i kryer në Tiranë në datë 22 Qershor 2020 Përmbytja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. lëshuar nga Re/Max Plus.
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Avdyl Turbetari në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, (profesioni Pllakashtrues)
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjon Preka në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, (profesioni Pllakashtrues)
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Bledi Goleshi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik, (profesioni Pllakashtrues)
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjergj Lekndreaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin

- Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi për Sigurimin Teknik (profesion hekurthyes).
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Alfons Gjellaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesion hekurthyes).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Martin Marku në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (profesion hekurthyes).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gëzim Qetaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik, (profesion hekurthyes).
  - Dëshmi Kualifikimi për Sigurimin Teknik Gëzim Boshti (profesion hekurthyes).
- 
- Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjeto Proroj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (profesioni saldator)
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjon Prendi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni saldator).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Gjokë Skollaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik (profesioni saldator).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Sandër Nika në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik (profesioni saldator).
  - Kontratë Pune e Rinovuar datë 04.01.2021 lidhur ndërmjet shoqërisë Nika SHPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Sokol Qetaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Specialist sipas kualifikimeve qe disponon, , Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik (profesioni saldator).

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në

*procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik Të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Në ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij përcakton se: “Arsimi dhe formimi profesional ka për mision: a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare; c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.” Ndërsa në pikën 17 të nenit 4 të po këtij ligji thuhet se: “Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Ndërkohë sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar, *Kualifikimi profesional*” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies te një ofrues i AFP-së, i përmbyllur me provime dhe i certifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë).

III.1.6. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit , të dokumenteve të procedurës së prokurimit si më sipër cituar, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar disponimi nga operatorët ekonomikë të punëtorëve të specializuar në ndërtim me profesion elektrikist përkatësisht 2 punonjës; karpentier përkatësisht 4 punonjës; hekurkthyes përkatësisht 4 punonjës;

saldator përkatësisht 5 punonjës; hidraulik përkatësisht 2 punonjës; murator përkatësisht 3 punonjës; pllakashtrues përkatësisht 6 punonjës; bojaxhi përkatësisht 10 punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/licenca e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nika” në përmbushje të kriterit sa më sipër rezulton se nuk është dorëzuar dokumentacion i plotë në drejtim të provueshmërisë së kualifikimit profesional të punonjësve. Referuar kriterit të kualifikimit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi profesionale të punonjësve. KPP vëren se operatori ekonomik ankimues Nika SHPK për një pjesë të konsiderueshme të punonjësve ka paraqitur vetëm kontrata pune dhe Dëshmi Kualifikimi të sigurimit teknik/Certifikata mbi sigurimin teknik. Konkretisht për punonjësit me profesion murator janë paraqitur vetëm kontrata pune dhe certifikata të sigurimit teknik. Për punonjësit me profesion bojaxhi vetëm dy prej tyre disponojnë Certifikatë Pjesëmarrjeje në kursin me temë: “Bojaxhi” kodi. B0013 i kryer në Tiranë në datë 29 Qershor 2020. Përmbajtja formuese e kursit dhe certifikata janë të njohura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, lëshuar nga Re/Max Plus SHPK ndërsa për dhjetë prej tyre janë paraqitur vetëm kontrata pune dhe dëshmi të kualifikimit për sigurimit teknik duke mos plotësuar numrin e kërkuar në kriterin e veçante të kualifikimit për 10 bojaxhinj të pajisur me dëshmi profesionale. Po ashtu edhe për profesionin karpentier vetëm dy nga punonjësit janë të pajisur me Certifikatë Pjesëmarrjeje nga Re/Max Plus SHPK, ndërsa të tjerët vetëm me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. E njëjtë është edhe për punonjësit me profesion pllakashtrues ku për 3 prej tyre janë paraqitur certifikata trajnimi nga Re/Max Plus SHPK dhe për 3 të tjerë vetëm dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Lidhur me këtë fakt, KPP gjykon se dokumenti Dëshmi për kualifikimin e sigurimit teknik/Certifikatë mbi sigurimin teknik të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues për pjesën më të madhe të punonjësve, ka për qëllim sigurimin teknik të punonjësve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në përputhje **me ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Të Instalimeve Elektrike”**, i ndryshuar, por nuk zëvendëson në asnjë rast dëshminë profesionale të cilën autoriteti kontraktor e ka kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit për të gjithë punonjësit. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik Nika SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk arrin të provojë se disponon punonjës të pajisur me dëshmi profesionale, në përputhje me numrin e kërkuar në kriterin e veçante të kualifikimit.

III.1.8. Gjithashtu për punonjësit me profesion elektrikist, KPP vëren se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur për njërin prej tyre kontratë pune, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik, dhe Certifikatë Trajnimi Kurs Trajnimi për Elektrikist lëshuar nga AQSCERT. Ndërsa për punonjësin tjetër vetëm kontratë pune dhe Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik. I njëjti fakt konstatohet edhe për punonjësit me profesion hidraulik nga ku rezulton se për njërin prej tyre ankimuesi ka paraqitur Kontratë Pune, Certifikatë mbi sigurimin teknik, Certifikatë Trajnimi Kurs



Trajnimi për Hidraulik lëshuar nga AQSCERT dhe për punonjës të tjerë ka paraqitur Kontratë Pune, Certifikatë mbi sigurimin teknik (profesioni hidraulik), Certifikatë për mbarimin e kursit hidraulik lëshuar nga Subjekti privat i formimit profesional S.O.L Korçë. Lidhur me këta punonjës KPP vëren se certifikatat e trajnimit të lëshuar për punonjësit me profesion elektrikist dhe hidraulik nga kompania Aqscert, referuar korrespondencës së Komisionit të Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk mund të konsiderohen të vlefshme. Konkretisht me shkresën nr. 944/3 prot., datë 25.09.2020 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon: *“Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga operatori ekonomik, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, janë paraqitur Certifikata Trajnimi, lëshuar nga shoqëria AQSCERT për profesione të ndryshme të ndërtimit.*

*Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, nenit 28, pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, KPP ju drejtohet ju si institucion kompetent për një sqarim lidhur me faktin nëse shoqëria AQSCERT është e akredituar për të ofruar kurse trajnimi për formim profesional për kualifikime në përputhje me Ligjin Nr.15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, dhe nëse po cilat janë profesionet e certifikuara që trajnohen prej saj.”*

III.1.9. Në datën 06.10.2020, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 944/5 prot., shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe të Aftësisimit Profesional, me nr. 17969/1 prot., datë 05.10.2020 me objekt *“Kthim përgjigjeje”*, ku thuhet shprehimisht se: *“Në përgjigje të shkresës tuaj nr.944/3 prot, datë 25.09.2020, protokolluar me tonën me nr.17969 prot., datë 28.09.2020 me objekt “Kërkesë për informacion” ju bëjmë me dije se pas verifikimeve të kryera rezulton se, shoqëria AQSCERT, nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.*

III.1.10. Referuar korrespondencës sa më sipër, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori Nika SHPK për punonjës të tjerë me profesion elektrikist dhe hidraulik, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi institucioni lëshues i certifikatave të trajnimit, konkretisht shoqëria AQScert, nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë". Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmëri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me

Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar nga një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar. Për sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në kushtet kur shoqëria AQScert, nuk është e licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*”, Certifikatat e Trajnimit, lëshuar nga AQScert për “Kurs Trajnimi për Elektricitist” dhe “Kurs Trajnimi për Hidraulik” nuk mund të konsiderohen se përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor për “*dëshmi profesionale të punonjësve*”, në dokumentet e tenderit.

III.1.11. Sa më sipër pretendimet e ankimuesit se ai ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke paraqitur certifikata të sigurimit teknik dhe certifikata trajnimi nuk është i bazuar në rastin konkret. Sikundër pasqyruar dhe arsyetuar më sipër ankimuesi nuk ka paraqitur për të gjithë punonjësit e kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit dëshmi profesionale. KPP gjykon se edhe në rastin kur janë paraqitur certifikata trajnimi, disa prej tyre (ato të lëshuara nga kompania Aqscert) nuk rezultojnë të vlefshme pasi janë lëshuar nga subjekt i palicencuar, që nuk ka të drejtë të kryejë kurse trajnimi profesionale. Ndërsa sa i takon Dëshmisë së kualifikimit të sigurimit teknik e paraqitur për pjesën më të madhe të punonjësve, KPP gjykon se ajo nuk zëvendëson dëshminë profesionale të cilën autoriteti kontraktor e ka kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit. Në këtë kuptim KPP gjykon se ankimuesi nuk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm lidhur me dëshmitë profesionale të punonjësve duke mos përmbushur kështu kriterin e veçantë të kualifikimit.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.12. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në

*rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-87312-02-16-2021, me objekt “Rikonstrukcion i tregut fshatar”, me Fond limit 49.998.000 (dyzet e nëntë milion e

nëntëqind e nëntëdhjet e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 608 Protokoli, Datë 15.04.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**